



Planuar / Dorezuar Prijmjefto/Prodato Received/Delivered	12.05	3	viti god year
Organ /Njesie Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Print No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSTICK	4224/2023		118



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.490/2023**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.490/2023 të datës 13.03.2023 të parashtruar nga ankuesja kundër Vendimit Nr.01-116/02-3910 të datës 21.02.2023 të Komisionit Disiplinor, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.05.2023, mori këtë:**

**V E N D I M**

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.490/2022 e datës 13.03.2023 e parashtruar nga ankuesja**
- II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr:01-116/02-3910 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjakovës i datës 21.02.2023.**

**A r s y e t i m**

Ankuesja e punësuar në Komunën e Gjakovës, me datë 08.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 1577/2023 e regjistruar me shenjen A.nr.338/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit të datës 30.01.2023 të Komisionit Disiplinor përmes të cilit ankuesja ishte pezulluar nga puna deri në shqyrtimin e procedurës disiplinore. Po ashtu, ankuesja me datë 13.03.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 2575/2023 e regjistruar me shenjen A.nr.490/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës

për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të datës 21.02.2023 të Komisioni Disiplinor përmes të cilit ankueses i është shqiptuar masë disiplinore.

Meqenëse, të dy ankesat e parashtruara nga ankuesja kanë qenë për aktet e nxjerra nga Komisioni Disiplinor lidhur me të njëjtën objekt shqyrtimi, gjegjësisht inicimin e procedurës disiplinore dhe shqiptimin e masës disiplinore, Kryetari i Këshillit me datës 24.03.2023 ka nxjerrë Vendimin VK/2023 me numër protokoll:2982/2023 përmes të cilit vendim ankesa e ankueses A.nr.338/2023 e datës 08.02.2023 është bashkuar me ankesën A.nr.490/2023 të datës 13.03.2023, ndërsa lënda tani e tutje do të trajtohet në tërsi nën shenjën A.nr.490/2023.

Ankuesja në ankesat e saj të parashtruar në Këshill pretendon se udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankueses sikurse edhe Komisioni Disiplinor me rastin e inicimit të procedurës disiplinore, njëherit shqiptimit të masës disiplinore kanë cenuar rëndë rregullat e procedurës administrative, kanë bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe kanë aplikuar gabimisht dispozitat e ligjit material, pasi që nuk kanë marr për bazë deklaratimet dhe provat e ankueses në seancat e mbajtura nga Komisioni Disiplinor pasi që nuk janë shqyrtuar shkresat e Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave në kuadër të Agjencisë së regjistrimit Civil të Kosovës kundër vendimeve të Komisionit për Ndërrime dhe Korrigjime në Sektorin e Gjendjes Civile dhe po ashtu deklaratimet e nëpunësve apo vartësve të ankueses se e njëjta është sjellë keq me ta janë të paqëndrueshme sikurse e njëjta pretendon se ndaj saj udhëheqësi i drejtpërdrejtë gjatë seancave të mbajtura është sjellë në mënyrë jo etike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me datë 01.03.2023 dhe datë 27.03.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit te Komuna e Gjakovës, ndërsa me datë 15.03.2023 dhe datë 05.04.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sipas kërkesës së Kryetares së Kolegjit, me datë me 19.04.2022 ka nxjerrë Vendimin VK/2023, përmes të cilit, ankesës së ankuesit ia ka vazhduar afatin e vendimmarrjes lidhur me këtë çështje ankimore edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr. protokoll 1577/2023 të datës 08.02.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim i Komisionit Disiplinor në Komunën e Gjakovës me numër 01-112/03-2132 i datës 30.01.2023; Vendim i Komisionit Disiplinor në Komunën e Gjakovës me numër 01-070/01-10770 i datës 28.04.2022; E-mail nga T.V. për K.A. i datës 20.01.2023; E-mail nga T.V. për K.A. i datës 12.12.2022; E-mail nga T.V. për K.A. i datës 12.12.2022; E-mail nga T.V. për K.A. i datës 01.11.2022; E-mail nga T.V. për K.A. i datës 20.01.2023; E-mail nga K.A. për T.V. i datës 20.01.2023; E-mail nga T.V. për K.A. i datës 20.01.2023; Kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore me numër 01-116/01-1480 i datës 20.01.2023; Pliko me numër R2774784 i datës 06.02.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokoll 2230/2023 i datës 01.03.2023; Përgjigje në ankesë me numër protokoll 2690/2023 i datës 15.03.2023; Akt Emërim i T.V. me numër AE.Nr.01-112/02-37391 i datës 13.12.2021; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 14.01.2019; E-mail nga K.A. për K.B. i datës 13.04.2022; Akt përcjellës i datës 03.02.2022; Ankesë nga M.Q. me numër protokoll 01-070/01-2517 i datës 01.02.2022; Ankesë nga L.G. dhe V.G. me numër protokoll 02-070/01-7518 i datës 25.03.2022; E-mail nga D.Rr. për K.A. i datës 28.03.2022;

Ankesë nga Q.I. me numër protokolli 02-070/01-7643 i datës 28.03.2022; Rregullore (QRK)-Nr.04/2015 për kodin e mirësjelljes në shërbimin civil të Republikës së Kosovës; Librezë e Q.I. e datës 14.01.2023; Letërnjoftim i Q.I.; E-mail nga Q.I. për K.A. i datës 27.03.2022; Vendim për formimin e komisionit disiplinor me numër 01Nr.112/01-4928 i datës 03.03.2021; Vendim me numër 01Nr.112/02-21498 i datës 16.09.2022; E-mail nga M.Q. për K.A. i datës 19.01.2023; E-mail nga K.A. për T.V. i datës 20.01.2023; E-mail nga T.V. për K.A. i datës 20.01.2023; E-mail nga T.V. për K.A. i datës 12.12.2022; E-mail nga T.V. për K.A. i datës 02.11.2022; Deklaratë nga Sh.Th. i datës 24.11.2022; E-mail nga M.Q. për K.A. etj. i datës 13.12.2022; E-mail nga M.Q. për K.A. i datës 22.11.2022; Ankesë me numër protokolli 22879 i datës 24.10.2022; Ankesë nga H.B. e datës 28.11.2022; Kërkesë nga C.T. e datës 16.12.2022; Ankesë nga F.Th. me numër protokolli 01-070/01-28991 i datës 22.12.2022; Letërnjoftim i F.Th.; Ankesë nga M.A. me numër protokolli 01-070/01-28856 i datës 21.12.2022; Vendim i Komisionit Disiplinor në Komunën e Gjakovës me numër protokolli 01-112/03-2132 i datës 31.01.2023; Fletë dorëzimi me numër 01-112/03-2132 i datës 30.01.2023; Procesverbal në seancën e komisionit disiplinor i datës 27.01.2023; Procesverbal në seancën e komisionit disiplinor i datës 31.01.2023; Procesverbal në seancën e komisionit disiplinor i datës 31.01.2023; Procesverbal në seancën e komisionit disiplinor i datës 31.01.2023; Procesverbal në seancën e komisionit disiplinor i datës 31.01.2023; Procesverbal në seancën e komisionit disiplinor i datës 01.02.2023; E-mail nga L.R. për D.L. i datës 30.01.2023; E-mail nga D.L. për L.R. i datës 30.01.2023; E-mail nga L.R. për D.L. i datës 27.01.2023; Procesverbal në seancën e komisionit disiplinor i datës 01.02.2023; Certifikatë e F.K. e vdekjes me numër V10558429 i datës 29.12.2022; Vendim me 02.nr.prot.203-01-25119 i datës 04.11.2022; Vendim me 02.nr.prot.203/01-9191 i datës 14.04.2022; shkresë të dhënat e qytetarit; Procesverbal në seancën e komisionit disiplinor i datës 03.02.2023; Procesverbal në seancën e komisionit disiplinor i datës 03.02.2023; Procesverbal në seancën e komisionit disiplinor i datës 03.02.2023; Procesverbal në seancën e komisionit disiplinor i datës 02.02.2023; Procesverbal në seancën e komisionit disiplinor i datës 02.02.2023; Procesverbal në seancën e komisionit disiplinor i datës 02.02.2023; Procesverbal në seancën e komisionit disiplinor i datës 02.02.2023; Procesverbal në seancën e komisionit disiplinor i datës 01.02.2023; Procesverbal në seancën e komisionit disiplinor i datës 01.02.2023; Procesverbal në seancën e komisionit disiplinor i datës 06.02.2023; E-mail nga T.V. për M.L. etj. i datës 23.11.2022; Procesverbal në seancën e komisionit disiplinor i datës 06.02.2023; Procesverbal në seancën e komisionit disiplinor i datës 06.02.2023; Procesverbal në seancën e komisionit disiplinor i datës 06.02.2023; E-mail nga L.N. për L.R. i datës 02.02.2023; E-mail nga L.R. për L.N. i datës 27.01.2023; E-mail nga L.R. për L.N. i datës 03.02.2023; E-mail nga L.N. për L.R. i datës 02.02.2023; E-mail nga L.R. për L.N. i datës 27.01.2023; Procesverbal në seancën e komisionit disiplinor i datës 20.02.2023; Procesverbal në seancën përfundimtare të komisionit disiplinor i datës 21.02.2023; Vërejtje me numër protokolli 116/01-15420 i datës 16.06.2021; Flete dorëzimi me numër 02-116/01-15420 i datës 16.06.2021; Vendim i Komisionit Disiplinor në Komunën e Gjakovës me numër 01-116/02-3910 i datës 21.02.2023; Flete dorëzimi me numër 01-116/02-3910 i datës 23.02.2023; Plikon me numër R2769001 i datës 10.03.2023; Ankesën me nr. protokolli 2575/2023 të datës 13.03.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e Kryetarit të Këshillit i datës 24.03.2023; Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 21.02.2023; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore i datës 20.01.2023; E-mailin e datës 07.07.2022 dërguar nga H.B për ankuesen; E-mailin e datës 08.07.2022 dërguar nga ankuesja për H.B; E-mailin e datës 26.07.2022 dërguar nga ankuesja për K.A; E-mailin e datës 08.08.2022 dërguar

nga ankuesja për K.A; E-mailin e datës 13.10.2022 dërguar nga ankuesja për H.B; E-mailin e datës 18.11.2022 dërguar nga ankuesja për K.A; E-mailin e datës 30.01.2023 dërguar nga ankuesja për H.B; Dosja e Vendimit Nr.87/2022 datë 23.11.2022; Vendimin Nr.87/2022 të datës 23.11.2022 i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave në kuadër të ARC-së; Vendimin e datës 17.10.2022 të Zyrës së Gjendjes Civil në Komunën e Gjakovës; Vendimin e datës 23.06.2022 të Zyrës së Gjendjes Civile në Gjakovë; Dosja e Vendimit Nr.90/2022 datë 12.12.2022; Vendimin Nr.90/2022 të datës 13.12.2022 i Komisionit për Shqyrtimin e Ankesave në kuadër të ARC-së; Vendimin e datës 17.10.2022 të Zyrës së Gjendjes Civil në Komunën e Gjakovës; Vendimin e datës 22.07.2022 të Zyrës së Gjendjes Civil në Komunën e Gjakovës; Shkresën e Policisë së Kosovës drejtuar Komunës së Gjakovës e datës 28.02.2023; Lista e vlerësimeve të rezultateve në punë; E-mailin e datës 22.12.2022 dërguar nga ankuesja për K.A me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 faqesh; Raportet vjetore të datës 22.12.2022 për Zyrën e Gjendjes Civile në Gjakovë; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 27.03.2023; Përgjigjen në kërkesë të datës 05.04.2023; Akt emërimit e ankueses të datës 20.12.2021; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën "Udhëheqës i Sektorit të Gjendjes Civile-AD/060; Vërejtjen e datës 16.06.2021 me fletë dorëzim; E-mailin e datës 19.01.2023 dërguar nga M.Q për K.A; E-mailin e datës 20.01.2023 dërguar nga K.A për ankuesen me korrespondencën e bashkangjitur prej 3 faqesh; Deklaratën e datës 24.11.2022 të Sh.Th; E-mailin e datës 13.12.2022 dërguar nga M.Q për K.A; E-mailin e datës 22.11.2022 dërguar nga M.Q për K.A; Ankesën e datës 24.10.2022 të parashtruar nga A.M për Drejtorinë për Punë të Përgjithshme; Ankesën e datës 28.11.2022 të parashtruar nga H.B; kërkesën e datës 16.12.2020; Ankesën e datës 22.12.2021 dërguar nga F.Th për Kryetari e Komunës; Ankesën e datës 21.12.2022 të bërë nga M.A për ankuesen; Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 30.01.2023; Vendimin e korigjuar të Komisionit Disiplinor i datës 30.01.2023; Flete dorëzimit e datës 30.01.2023; E-mailin e datës 23.01.2023 dërguar nga L.R për A.H dhe të tjerët; E-mailin e datës 27.01.2023 dërguar nga L.R për A.H; E-mailin e datës 27.01.2023 dërguar nga L.R për A.V; E-mailin e datës 27.01.2023 dërguar nga L.R për L.N; E-mailin e datës 03.02.2023 dërguar nga L.R për L.N; E-mailin e datës 27.01.2023 dërguar nga L.R për D.L; E-mailin e datës 30.01.2023 dërguar nga L.R për D.L; E-mailin e datës 27.01.2023 dërguar nga L.R për M.C; E-mailin e datës 27.01.2023 dërguar nga L.R për M.L; E-mailin e datës 27.01.2023 dërguar nga L.R për M.C; E-mailin e datës 27.01.2023 dërguar nga L.R për M.L; E-mailin e datës 27.01.2023 dërguar nga L.R për H.B; E-mailin e datës 27.01.2023 dërguar nga L.R për D.H; E-mailin e datës 27.01.2023 dërguar nga L.R për Q.I; E-mailin e datës 27.01.2023 dërguar nga L.R për N.M; E-mailin e datës 27.01.2023 dërguar nga L.R për S.K; E-mailin e datës 27.01.2023 dërguar nga L.R për K.A; E-mailin e datës 27.01.2023 dërguar nga L.R për ankuesen; E-mailin e datës 27.01.2023 dërguar nga L.R për Xh.H; E-mailin e datës 27.01.2023 dërguar nga L.R për M.Q; E-mailin e datës 27.01.2023 dërguar nga L.R për M.M; E-mailin e datës 27.01.2023 dërguar nga L.R për K.Ll; E-mailin e datës 27.01.2023 dërguar nga L.R për F.K; Procesverbalin e seancës disiplinore të datës 27.01.2023; Procesverbalet e seancave disiplinore të Komisionit Disiplinor; E-mailin e datës 27.01.2023 dërguar nga L.R për D.L; Çertifikatën e vdekjes të datës 29.12.2022; Shkresën e datës 07.11.2022; Vendimin e datës 04.11.2022 të Zyrës së Gjendjes Civile të K. Gjakovës; Vendimin e datës 14.04.2022 të Zyrës së Gjendjes Civile të K. Gjakovës; Shkresën e titulluar "Regjistrion Udhëheqësja pa Dok"; E-mailin e datës 23.11.2022 dërguar nga ankuesja për M.L dhe të tjerët; E-mailin e datës 23.11.2022 dërguar nga L.N për L.R; E-mailin e datës 23.11.2022 dërguar nga L.R për L.N.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankueses është e *pabazuar* sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në provat e administruara, gjegjësisht Akt Emërimit e datës 13.12.2021 ka konstatuar se ankuesja ka statusin e nëpunëses civile dhe mban pozitën e punës "*Udhëheqës i Sektorit të Gjendjes Civile*" në kuadër të Komunës së Gjakovës, ndërsa ndaj të njëjtës Drejtori i Drejtorisë për Punë të Përgjithshme Administrative, gjegjësisht udhëheqësi i saj i drejtpërdrejtë me datë 20.01.2023 ka paraqitur kërkesë për inicim të procedurës disiplinore me arsyet e dhëna si në vijim: mos përmbushje e detyrave të punës; moszbatim të dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; sjellje e parregullt gjatë kohës së punës me mbikëqyrësit, kolegët vartësit dhe me publikun; kryerje e përsëritur brenda ose jashtë orarit zyrtar të veprimeve që cenojnë nëpunësit civil, institucionin apo Shërbimin Civil më tërsi; si dhe Shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Gjakovës kërkesën për inicimin të procedurës disiplinor të datës 20.01.2023 e ka pranuar nga Njësia për menaxhimin e Burimeve Njerëzore përmes e-mailit me datë 23.01.2023 ndërsa fillimisht përmes me numër:01-112/03-2132 të datës 30.01.2023 ankuesen e ka pezulluar nga marrëdhënia e punës deri me datë 22.02.2023, gjegjësisht deri në përfundimin e zhvillimit të procedurës disiplinore veprim ky i ndërmarr sikurse përcaktohet me paragrafi 6 të nenit 13 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ndërsa përmes Vendimit Nr.01-116/02-3910 të datës 21.02.2023 Komisioni Disiplinor ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore "*ndalim i 30% të pagës për periudhën 3 mujore*" për shkak se të njëjtën e ka gjetur përgjegjëse për shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.3, 3.6 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik si dhe shkelje të dispozitave të nenit 6 dhe 7 paragrafi 1, nenin 8 paragrafi 2, nenet 11, 27 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Kodin e Etikës të Komunës së Gjakovës.

Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e legjislacionit material që rregullojnë fushën e përgjegjësisë disiplinore dhe shqiptimin e masave disiplinore të paracaktuara me nenin 45 dhe nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.3, 3.6 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "*45.Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit; 46. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.6 shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi"* dhe ka ardhur në përfundimin se nëpunësit civil mbajnë përgjegjësi disiplinore në rastet kur konstatohet se të njëjtit me veprim ose mosveprim kanë shkelur dispozitat e ligjit material dhe legjislacionit në fuqi ndërlidhur me detyrat funksionale dhe përgjegjësit e punës për pozitën që mbajnë, mirëpo vetëm nëse për një çështje të tillë plotësohen parakushtet ligjore për zhvillimin e procedurës disiplinore në pajtueshmëri me Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, sikurse personat zyrtar po ashtu janë përgjegjës nëse në cilësi të autoritetit zyrtar përkitazi me mandatin ligjor që buron nga akti i themelimit të marrëdhënies së punës të ndërlidhur me përshkrimin e detyrave të punës

në kuptim edhe të nenit 6 dhe 7 paragrafi 1, nenin 8 paragrafi 2, nenet 11, 27 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nëse të njëjtit kryejnë veprime që cenojnë apo shkelin parimin e barazisë dhe mos diskriminimit, parimin e objektivitetit dhe paanësisë, parimin e pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme, parimin e informimit dhe ndihmës aktive të ndërlidhura me përgjegjësinë për procedurën dhe vendimmarrjen në kuadër të autoritet zyrtar që ushtron sipas mandatit që ia ka njohur ligji material.

Kolegji i Këshillit ka gjetur se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e ka njoftuar ankuesen për hapjen e procedurës disiplinore ndaj saj, sikurse të njëjtën e ka ftuar të paraqitet pranë Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjakovës në seancën e datës 20.02.2023 së bashku me iniciuesin e procedurës disiplinore për tu njohur me variantin e tyre të ngjarjes sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 12 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku ndër tjerash përcaktohet se: *"Komisioni disiplinor kryen edhe këto veprime deri në marrjen e vendimit: Fton iniciuesin dhe nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore për t'u njohur me variantin e tyre të ngjarjes apo të problemit"*, dhe po ashtu Kolegji i Këshillit ka gjetur se Komisioni Disiplinor në administrimin shkresave të lëndës ka paraqitur edhe faktet e prezantuara nga ankuesja nga rrjedh se është zbatuar frymë e ligjit sikurse përcaktohet me nenin 94 dhe 95 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Pala, në çdo fazë të procedurës, ka të drejtë të paraqesë mendime, shpjegime për faktet, rrethanat apo edhe çështjet ligjore, që kanë të bëjnë me procedurën përkatëse, së bashku me provat e dokumentet përkatëse, në të cilat i mbështet ato si dhe të paraqesë propozime për zgjidhjen e çështjes. 95.1 Para marrjes së një vendimi përfundimtar, organi publik që zhvillon procedurën administrative, duhet të njoftojë palën për të drejtën e saj për t'u dëgjuar"*, dhe po ashtu ka marr deklarata apo ka ftuar në cilësi të dëshmitarëve nëntëmbëdhjetë (19) persona prej të cilëve pjesa dërmuese nëpunës civil apo vartës të ankueses, e qytetar të cilët janë ankuar tek udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses për sjelljen e saj ndaj tyre dhe mos zbatim të vendimeve të Komisionit për Ndërrime dhe Korrigjime në Sektorin e Gjendjes Civile, veprime këto në pajtueshmëri me funksionin dhe mandatin e Komisionit Disiplinor sikurse përcaktohet me nenin 12 paragrafi 1, 2 dhe paragrafi 3 nën paragrafi 31, 3.2 dhe 3.4 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Nga shkresat e administruara të lëndës dhe konstatimit të gjendjes faktike, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Komunës së Gjakovës me rastin e shqiptimit të masës disiplinore *"ndalim i 30% të pagës për periudhën 3 muajore"* ndaj ankueses përmes Vendimit Nr.01-116/02-3910 të datës 21.02.2023 ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e ligjit material, Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe dispozitave të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, pasi që nga procesverbalet e seancave të mbajtura me datë 27.01.2023, 31.01.2023, 01.02.2023, 02.02.2023, 03.02.2023, 06.02.2023, 20.02.2023 dhe 21.02.2023 ka ardhur në përfundimin se ankuesja gjatë ushtrimit të autoritetit zyrtar në cilësi të *"Udhëheqëses se Sektorit të Gjendjes Civile"*, gjegjësisht gjatë ushtrimit të detyrave funksionale ka vepruar në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 2 dhe 3 dhe nenin 8 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"6. 2. Personat në të njëjtën situatë trajtohen në mënyrë të njëjtë. Dallimi në trajtimin e çështjeve justifikohet vetëm nëse dhe për aq sa ai përputhet me ndryshimet objektive të çështjeve përkatëse. 3. Organi Publik, në mënyrë të veçantë, shmang çdo diskriminim të padrejtë ashtu siç përcaktohet me Ligjin kundër diskriminimit; 8.2 Një veprim administrativ nuk mund të ndryshojë në mënyrë të pajustificuar nga një praktikë administrative e*

*mëparshme e të njëjtit organ për raste të njëjta a të ngjashme”* ngase në parim nuk i ka respektuar apo nuk ka pasur qëndrim të njëjtë ndaj të gjitha vendimeve që janë nxjerrë nga Komisioni për Ndërrime dhe Korrigjime në Sektorin e Gjendjes Civile në kuadër të Komunës së Gjakovës, prandaj mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit duke mos mohuar vërtetësinë dhe efektin juridik të vendimeve të paraqitura në cilësi provave nga ankuesja sikurse janë Vendimi i datës 23.11.2023 me numër:87/2022 i Agjencisë së Regjistrimit Civil të Kosovës, Vendimin e datës 17.10.2022 me numër:02-201/02-23406 të Zyrës së Gjendjes Civile në Gjakovë, Vendimi i datës 13.12.2023 me numër:90/2022 i Agjencisë së Regjistrimit Civil të Kosovës, Vendimin e datës 17.10.2022 me numër:02-201/02-23395 të Zyrës së Gjendjes Civile në Gjakovë, përmes të cilave synon të justifikoj veprimet e saj për shkak të mos zbatimit të vendimeve të Komisioni për Ndërrime dhe Korrigjime në Sektorin e Gjendjes Civile me arsyetimin sepse vendimet e tilla administrative janë ndërmarr me shkelje të dispozitave përkatëse ligjore që rregullojnë fushën e gjendjes civile gjegjësisht ndërrimin apo korrigjimin e emrit personal dhe korrigjimin e të dhëna në LTHV vdekjes, mirëpo Kolegji i Këshillit thekson fakti se pikërisht ankuesja kishte zbatuar Vendimet e datës 04.11.2022 me shifër 02.nr.prot.203-01-25-119 dhe ai i datës 14.04.2022 me shifër 02.nr.prot.203-01-9191 të nxjerra mbi po të njëjtën bazë apo praktike administrative nga i njëjti komision, gjegjësisht Komisioni për Ndërrime dhe Korrigjime në Sektorin e Gjendjes Civile në kuadër të Komunës së Gjakovës, sikurse është konstatuar fakti se që të gjithë të ftuarit në cilësi të dëshmitarëve në seancat dëgjimore të mbajtura nga Komisioni Disiplinor kanë deklaruar se ankuesja ndaj tyre apo gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ka përdorur gjuhë apo sjellje që nuk përkon me etiken dhe sjelljen e një zyrtari në kuadër të shërbimit civil prandaj konstatimet e tilla për veprimet apo mos veprimet e ankueses përbëjnë shkelje të rënda disiplinore të përcaktuar me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.3, 3.6 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, sikurse konstatohet fakti se ankuesja me sjelljet e saja me veprim ose mos veprim ka konsumuar edhe elementet e përgjegjësisë disiplinore të përcaktuara me nenin 45 i të njëjtit ligj, ngase palët në procedurë janë dëmtua për shkak se sektori që e njëjta ka udhëheq ka reflektuar paqëndrueshmëri në ofrimin e shërbimeve dhe sjelljes me palë apo me nëpunësit civil.

Prandaj, nga se u tha si më lartë, mbi bazën e gjetjeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi dhe analizimit të bazës ligjore, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankueses ka vepruar në pajtueshmëri me kompetencat që ligji material i ka njohur, gjegjësisht nenin 48 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 –për Zyrtarët Publik ngase masa e shqiptuar disiplinore kategorizohet si masë që shqiptohet ndaj shkeljeve të rënda, sikurse procedura disiplinore dhe veprimet procedurale të Komisionit Disiplinor janë marr në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 11, 12 dhe 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3, 4 dhe 5 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ngase përveç shqyrtimit të rrethanave dhe provave që ndërlidhen me rastin duke ftuar edhe dëshmitar, ka marr për bazë edhe masën tjetër (vërejte e datës 16.06.2021) e shqiptuara ndaj ankueses dhe e cila është në fuqi, sikurse masa e shqiptuar disiplinor është në proporcion me shkeljen e kryer nga ankuesja, sikurse është evident fakti se Vendimi KD.Nr.01/2023 i Komisionit Disiplinor i datës 21.02.2023 i goditur përmes kësaj ankese i përmban të gjitha elementet e detyrueshme të aktit administrativ të përcaktuar me nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, prandaj nga të dhënat dhe arsyetimi i këtij vendimi Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se ankesa e ankueses me pretendimet e paraqitura është e pabazuar dhe e njëjta është refuzuar sikurse në

dispozitivin e këtij vendimi ndërsa Vendimi Nr.01-116/02-3910 të datës 21.02.2023 të Komisionit Disiplinor ka mbetur në fuqi.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit thekson faktin se me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese ka pasur parasysh vendimin e Këshillit A.nr.339/2023 të datës 05.04.2023 lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë të ankueses, mirëpo në rastin konkret të shqyrtimit të ankesës së datës 13.03.2023 nga provat e administruara të lëndës të sjella nga organi i punësimit rezulton se masa disiplinor është shqiptuar në frymën e mos përmbushjes së detyrave funksionale dhe shkeljes së përsëritur të rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil sikurse edhe shkeljes së detyrimeve të përcaktuara me legjislacionin material, e që në rastin konkret nuk ndërlidhet me përmbushjen e detyrave të punës në kuptim të arritjes së objektivave të përcaktuara.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe të gjeturave të pasqyruar si në arsyetim të këtij vendimi si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.490/2023

**Avdyl BEKTESHI**

Zyrtar i Lart për Bashkëpunim Profesional

**Malsore GASHI BAJRAKTARI**

Kryetare e Kolegjit

### Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së